

K R Y E M I N I S T R I
ED I R A M A

V E N D I M
P Ë R

PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETETËRORE TË MINISTRIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e misionit, të fushave të përgjegjësive shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Misioni i ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është të ndihmojë dhe të mbrojë sipërmarrjen private, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të promovojë bashkëpunimin ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes.
3. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes e ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:
 - a) Investigon dhe trajton ankesat administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre;
 - b) Promovon transparencën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asiston sipërmarrjen në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore të lidhura me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, kundrejt institucioneve publike;
 - c) Ndërmjetëson komunikimin e sipërmarrjes me institucionet publike për zbatimin e kontratave, si dhe zhvillon mekanizma të zgjidhjes paraprake të mosmarrëveshjeve midis tyre;
 - ç) Inkurajon zhvillimin e partneritetit dhe komunikimit midis institucioneve publike dhe sipërmarrjeve si dhe organizatave përfaqësuese të tyre.
4. Me qëllim realizimin e veprimtarisë si më sipër, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes:
 - a) krijon platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre;
 - b) krijon regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes së cilit monitoron procesin ndërinstitucional dhe i raporton Kryeministrit çdo fillim muaji;
 - c) krijon rregulloren e procedurës së brendshme, e cila detajon procedurën e:
 - i. regjistrimit dhe të pranimit të ankesave, sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore;
 - ii. komunikimit dhe të investigimit të çështjeve të pranuar me institucionet e lidhura publike;
 - iii. mbledhjes së evidencave dhe të informacionit të nevojshëm nga institucione të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike dhe/ose personave të tretë;
 - iv. komunikimit midis institucioneve publike dhe të sipërmarrjes që ka kryer ankimimin; si dhe
 - v. raportimit dhe publikimit të statusit të ankesave të trajtuara.
5. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes nuk trajton çështje për të cilat është hapur një çështje gjyqësore, dhe/ose ka një vendim gjyqësor të formës së prerë.
6. Ngarkohet ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare"